

Teuta SHALA-PELI

**RRETH KONSOLIDIMIT TË SUNDIMIT VENEDIKAS NË
DURRËS, 1392-1394**

Vendosja dhe shtrirja e sundimit venedikas në Shqipëri, përballja me këtë sundim, kundërshtimi i tij, si dhe shumë çështje që e karakterizuan periudhën kohore 1392-1479, kanë gjetur trajtim të gjerë si te studiuesit vendas ashtu edhe të ata të huaj.¹ Gjithashtu edhe botimi i

¹ Si vepra dhe artikuj studimorë bazë lidhur me sundimin venedikas në Shqipëri, mund të veçojmë: Milan Shufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, Rilindja, Prishtinë 1968 (më tej: Shufflay, *Serbët dhe shqiptarët*); Alain Ducellier, *L'Albanie entre Byzance et Venise, Xe-XVe siècles*, London 1987; Luan Malltezi, *Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas 1392-1478* (Aspekte të jetës së tyre), Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë-Instituti i Historisë, Tiranë 1988, 210 (më tej: Malltezi, *Qytetet*); Ivan Božić, “Albania i Albanci tokom XIII, XIV I XV veka”, në *Glas: odelenje istorjski nauka*. Srpska Academia Nauka i Umetnosti, knj.III 1983, 56 (më tej: Božić, “Albania i Albanci”); Oliver Jenes Schmitt, *Arbëria Venedike 1392-1479*, Tiranë: K&B, 2007; Qerim Dalipi, *Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane (1355-1443)*, Tetovë: ARS-ZZ, 2012; Konstantin Jireček, *Nga Shkodra deri në Vlorë nëpër Shqipërinë mesjetare: kontribute për gjeografinë historike dhe mesjetën shqiptare*, përktheu nga origjinali dhe përgatiti për botim: Edmond Malaj, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë 2017; Pranvera Bogdani, *Balshajt lufta e principatës së Balshajve dhe të sundimtarëve të tjerë shqiptarë kundër Venedikut në 20 vjetët e para të shek. XV*, Akademia e Studimeve Albanologjike-Instituti i Historisë, Tiranë 2018. (Më tej: Bogdani, *Balshajt*); Luan Malltezi, “Përprjekjet dhe synimet e Venedikut për pushtimin e Durrësit (1386-1392)”, *Studime historike*, Tiranë 1977/3 (Më tej: Malltezi, “Përprjekjet dhe synimet”); Kasem Biçoku, “Shfrytëzimi i masave popullore gjatë sundimit venedikas”, *Studime historike*, Tiranë, 1975/4; Luan Malltezi, “Shkaqet e luftës së Balshës III kundër Republikës së Venedikut në 20 vjetët e para të shek. XV”, *Studime historike*, Tiranë, 1980/2; Pranvera Bogdani, “Lufta kundër Venedikut për çlirimin e Krahinës së Shkodrës dhe qyteteve të saj në fund të vitit 1404, mesi i 1405”, *Studime historike*, Tiranë, 1983/2; Branislav Milutinović, “Drivaštanci u Dubrovniku tokom XIV i XV veka”, *Vjetar i Arkivit të Kosovës*, Prishtinë, 1983/XVI-XVII; Luan Malltezi, “Abuzime të aparatit qeveritar në zotërimet e shtetit venedikas në Shqipëri (1392-1478)”, *Studime historike*, Tiranë, 1984/3; Branislav Millutinović, “Drishti nën

përmbledhjeve me dokumente² të cilat ndërlidhen me ngjarjet që përfshinin periudhën kohore nga fundi i shek. XIV deri në vitin 1479, kanë dhënë ndihmesë të madhe në thellimin e studimeve dhe njohjen e rrethanave lidhur me vendosjen dhe konsolidimin e këtij sundimi në Shqipëri. Mbi bazën e të dhënave burimore, si dhe literaturën relevante, në këtë punim do të trajtojmë një problem mjaft specifik sa i përket vendosjes së sundimit venedikas në Shqipëri. Fjala është për konsolidimin e këtij sundimi në Durrës.

Gjithnjë duke marrë parasysh politikën të cilën e aplikoi Republika e Venedikut pas marrjes së këtij qyteti, në vijim do t'i trajtojmë disa ngjarje dhe procese që e karakterizuan periudhën kohore 1392-1394, e cila njëkohësisht shënon fazën e përqendrimit dhe të përfundimit të sundimit venedikas në Durrës. Në këtë drejtim, burime me rëndësi përbëjnë dokumentet e shumta, përkatësisht vendimet të cilat i lëshonte Senati i Republikës së Venedikut, dhe ua dërgonte qeveritarëve të tyre të vendosur në Durrës, si dhe në përgjigjet që ky Senat iu kthente përfaqësuesve të Durrësit. Nga përmbajtja e atyre dokumenteve të cilat flasin për çështje të

sundimin e Venedikut”, *Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike Prishtinë*, 1985/5; Luan Malltezi, “Rreth monopolit të shtetit venedikas mbi drithin në Shqipëri në shek. XV”, *Studime historike*, Tiranë, 1986/1; Selim Daci, “Lezha nën sundimin e Venedikut”, *Studime për Epokën e Skënderbeut II*, Tiranë 1989; Zef Valentini, “Ekonomia agrare në rrethin e Shkodrës nën sundimin venedikas në shek. XV”, *Studime historike*, Tiranë, 1991/3-4; Jenes Schmitt, Oliver, “Marrëdhëniet e Venedikut me kishat para dhe gjatë luftës shqiptaro-osmane, roli i tyre dhe depërtimi i humanizmit në Shqipëri”, *Studime historike*, Tiranë, 2003/3-4.

² Nga përmbledhjet me dokumente mund të veçojmë: Sime Ljubić, *Listine o odnošajih izmedju južnoga slavenstva i Mletačke Republike*. Knjiga IV: od godine 1358 do 1403 (MSHSM, Zagreb 1874). (më tej: Ljubić, *Listine*); *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, college Tholloczy, L.- Jiriček, C. - Sufflay, E., vol. II, Vindobonae MCMXVIII (Më tej: *Acta et diplomata II*); Giuseppe [Joseph] Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, 25 vol., Palermo-Napoli-Roma-Venezia-München: Archivio di Stato di Venezia, 1967-1972, (më tej: AAV); *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë (shek. VIII-XV) II*. Përgatitur nga A. Buda, I. Zamputi, K. Frashëri, P. Pepo, Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranë, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1962; A. Buda & K. Biçoku, “Disa dokumente rreth marrëdhënieve të Skënderbeut me Venedikun në vitet 1447-1449”, *Studime historike*, nr. 3, Tiranë, 1967; *Burime tregimtare për historinë e Shqipërisë (shek. X-XV)*. Përgatitur nga K. Bozhuri, P. Liço, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Historisë, 1975; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV*, vëll. I (1400-1405). Përgatitur nga I. Zamputi dhe L. Malltezi, Tiranë, 1987 (Më tej: *Dokumente për historinë I*); *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV*, vëllimi III (1411-1415), përgatitur nga Injac Zamputi, Përparime Huta, Tiranë 2018; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV*, vëllimi II (1406-1410), pjesa e parë, përgatitur nga Injac Zamputi, Pranvera Bogdani, Tiranë 2019.

natyrave të ndryshme lidhur me sundimin venedikas në Shqipëri-Durrës, kemi hasur në elemente me rëndësi të cilat i referohen përqendrimit dhe përforcimit të sundimit të tyre jo vetëm në Durrës, por edhe më gjerë në tërë zotërimet e Topiajve.

Tashmë është e njohur se Durrësi prej vitit 1368 kur Karl Topia arriti që ta përfshijë në zotërimet e tij³ e deri në vitin 1392, me një shkëputje të vogël ishte nën zotërimin e familjes fisnike të Topiajve. Në vitin 1384 Balsha II arriti që ta merrte këtë qytet,⁴ të cilin e mbajti deri në shtator të vitit 1385, madje në dokumentet e lëshuara gjatë asaj kohe Balshën II e ndeshim me titullin Dukë i Durrësit (Dyrrachii dux).⁵ Në shtator të vitit 1385 Karl Topia përsëri e mori Durrësin,⁶ i cili deri në vitin 1392 mbeti nën zotërimin e Topiajve. Në mars të vitit 1392, Gjergj Topia i dorëzon kështjellën e Durrësit kapedanit venedikas të flotës së Adriatikut Saracen Dandolo (Saracenum Dandolo),⁷ ndërsa në fillim të gushtit të po atij viti, midis Gjergj Topisë dhe Saracen Dandolo u arrit një marrëveshje sipas së cilës Gjergj Topia pranonte që pas vdekjes së tij i gjithë qyteti të kalonte nën sundimin e Venedikut.⁸ Kjo marrëveshje u miratua në gjysmën e dytë të muajit gusht.

³ *Acta et diplomata II*, dok. 236. Në këtë dokument i cili mban datën 28 mars 1386, ndër të tjera thuhet se zoti Karl Topia, princ i Shqipërisë, nuk ka shumë kohë që shtiu në dorë Durrësin (...*dominus Karollus Topie, princeps Albanie, qui ut dicitur modo - cepit Dirachium...*).

⁴ Giuseppe Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, përkthyer nga Laura Leka, Tiranë: SHB "55", 143, 2009. (Më tej: Gelcich, *Zeta dhe Dinastia*).

⁵ *Srbskii Spomenicy ili stare risovolë, diplome, povelë, i sonošenija bosanski, serbski, hercegovacki, dalmatinski, i dubrovački kralëva, careva, banova, despota, knezova, vojvoda i vlastelina, a sobrani trudom Pavle Karano-Tvrtkovič*, Beogradu: Tipografii Knjažestva Srbije, 1840, 87-88; *Monumenta Serbica Spectantia Historiam Serbiae Bosnae Ragusii*, Edidit, Franz Miklosich Vienna, apud Guilelmum Braumüller, 1858, 202: "... Balša, Dyrrachii dux, confirmat privilegia Ragusinis data ab imperatore Stephano et fratre Georgio..."; Стојан Новаковић, *Законски споменици српских држава средњег века*, Српска краљевска академија, Београду, 1912, 197; Konstantin Jireček, *Nga Shkodra deri në Vlorë nëpër Shqipërinë mesjetare: kontribute për gjeografinë historike dhe mesjetën shqiptare*, përktheu nga origjinali dhe përgatiti për botim: Edmond Malaj, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë 2017, 90.

⁶ Rikthimi i Karl Topisë në Durrës ndodhi pas Betejës së Savrës, e cila u zhvillua më 18 shtator 1385, ku ushtria e Balshës II pësoi disfatë nga ushtria osmane, e për pasojë mbet i vrarë edhe vetë Balsha II. Gelcich, *Zeta dhe Dinastia*, 147; Bogdani, *Balshajt*, 55.

⁷ "1392, (circa 1. aprilis). „In Castro Durachii." *Georgius Topia dominus Durachii Saraceno Dandolo capitaneo generali culphi castrum Durachii pro ducali dominatione...*". *Acta et diplomata II*, dok. 480; Malltezi, *Qytetet*, 54.

⁸ Malltezi, "Përpjekjet dhe synimet", 161; Shufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, 135; At

Menjëherë pas arritjes së kësaj marrëveshjeje, Gjergj Topia me anë të përfaqësuesve të tij kishte kërkuar nga Republika e Venedikut respektimin, zbatimin dhe ratifikimin e saj. Më 9 gusht 1392 Republika e Venedikut, u kishte kthyer përgjigje nëntë kërkesave të parashtruara nga përfaqësuesit e Gjergj Topisë. Lidhur me kërkesën e parë për ratifikimin e marrëveshjes Sinjoria kishte dhënë këtë përgjigje: “... *disa përfaqësues të tij kërkojnë në emër të tij [Gjergj Topisë] që të kemi mirësinë të konfirmojmë dhe të ratifikojmë me një shkresë tone të hapur dhe të përforcuar me vulën e artë dokumentet e marrëveshjeve të përfunduara ndërmjet atij dhe të burrit fisnik zotit Saracen Dandulla, kapitenit tone të Gjirit, për çështjen e kështjellës dhe të qytetit të Durrësit etj, dhe meqë jemi të sigurt se zoti i përmendur do të respektojë plotësisht ndaj nesh çdo pikë që përmbahet në dokumentin e lartpërmendur, neve pranojmë dhe jemi të kënaqur që dokumentin në fjalë ta ratifikojmë dhe të bëjmë që të aprovohet me anën e një shkrese sonë të hapur ashtu siç e kërkojnë ata...*”⁹ Sidoqoftë, kjo marrëveshje e cila shënon rënien de jure të Durrësit në duart e venedikasve zyrtarisht u miratua më 18 gusht 1392 në kështjellën e Durrësit, ku përveç Gjergj Topisë dhe Saracen Dandolos, të pranishëm në pozitën e dëshmitarëve ishin: arqipeshkvi i Durrësit Johani (Johannem archiepiscopum Duracensem), Filip Barelli¹⁰ (domino Philippo Barello de Veneciis), Almero Lombardo (Almerò Lombardo de Veneciis), mjeshtri Nikolla (magistro Nicolao), Jakomell Boatelli nga Venecia (domino Jacomello Boatello de Veneciis), si dhe presbiteri Andriolo nga Venecia (*presbitero Andriolo de Venetiis*).¹¹

Hapa të rëndësishëm drejt shtrirjes dhe përforcimit të pushtetit të tyre në Durrës Republika e Venedikut bëri që nga marrja e Kështjellës së Durrësit në mars të vitit 1392. Në këtë drejtim, më 18 prill 1392, Senati i

Giuseppe (Zef) Valentini, *Vepra III (publicistikë, studime dhe tekste)*, Përgatitur nga: Ksenofon Kristafi; Ndrìçim Kulla; Dritan Thomollari, Plejad, Tiranë 2006, 137.

⁹ Ljubić, *Listine*, 292-293; *Acta et diplomata II*, dok. 483; AAV, p. I, t. II, nr.449.

¹⁰ Gjon Berisha, “Agjenti dhe tregtari Filip Barelli në oborin e Balshajve: influenza e tij në gjysmën e dytë të shek. XIV “, *Studime historike*, 2018, Vol. 72, nr. 1/2, 48.

¹¹ “*In castro Durachii presentibus domino Johanne dei gratia archiepiscopo Durachii, domino Phylippo Barello de Veneciis, domino Almerò Lombardo de Veneciis, magistro Nicolao filio quodam Francisci de Seravalle medico, domino Jacomello Boatello de Veneciis, presbitero Andriolo de Venetiis testibus convecatis et rogatis. Nobilis et egregius dominus dominus Georgius Topia dominus Durachii dedit et tradidit castrum Durachii de consensu et voluntate sua nobili et egregio viro domino Saraceno Dandulo sindaco et procuratore ac capitaneo generali culphi pro ducali dominatione Veneciarum hiis pactis et conditionibus*”. Ljubić, *Listine*, IV, 424; *Acta et diplomata II*, dok. 484. AAV, p. I, t. II, nr. 451; Malltezi, *Qytetet*, 54.

Venedikut duke u thirrur në ruajtjen dhe mbajtjen e Kështjellës së Durrësit merr vendim që për dy vjetët e ardhshme të zgjidhet një kështjellar (castellanus) dhe të dërgohet atje. Pozita e kështjellarit të parë (*primus castellanus castris Durachij*)¹² ju besua Pal de Kanali (Paulus de Canalj).¹³ Në vendimin e 18 prillit 1392, përveç kriterëve që ceken aty për përzgjedhjen e këtij kështjellari, si dhe shumë dhe mënyrës së pagesës, ajo që tërheq vëmendjen në këtë rast është edhe vendimi sipas të cilit kështjellarët duhej që të mbanin nga dy shërbyes me pagën e vet dhe me shpenzimet e veta, të cilët nuk duhet të jenë shqiptarë apo prej Durrësit (nec sint Albanenses vel de Durachio).¹⁴ Ky vendim tregon se Republika e Venedikut akoma pa e marrë nën zotërimin e saj tërë territorin e Durrësit u përkujdes që si në pozitat udhëheqëse ashtu edhe në stafin ndihmës të emërojnë persona të besueshëm.

Kompletimi i aparatit qeveritar

Pas vdekjes së Gjergj Topisë, Republika e Venedikut kujdes të veçantë i kushtoi emërimit të qeveritarëve venedikas në Durrës. Për më tepër, në këtë drejtim Republika e Venedikut kujdesej që të krijonte kushte të favorshme për personat të cilët i dërgonte në Durrës. Për këtë qëllim Republika e Venedikut në nëntor të vitit 1392, i udhëzonte proveditorët të cilët do t'i dërgonte në Durrës që të gjenin shtëpi a banesë ku mund të qëndrojnë rektori që do ta dërgonin bashkë me familjen e tij, e cila duhej që të ishte plotësisht në rregull dhe e përshtatur ashtu siç lypet dhe siç e kërkon e drejta.¹⁵

¹² AAV, p. I, t. II, nr. 451.

¹³ AAV, p. I, t. II, nr. 445. Mallezi, "Përpyekjet dhe synimet", 140.

¹⁴ "...*Quia providendum est de custodia et conservatione castris Durachii assignati per dominum dicti loci in manibus capitanei nostri culphy, ut ipse noster capitaneus possit accipere ballistarios suos et homines galearum quos ibi dimisit-vadit pars in bona gratia, quod pro ista vice tantum eligatur in isto consilio unus castellanus dicti castris per duos annos, et tantum plus quantum successor suus differret illuc ire, qui non possit esse minoris etatis quam triginta annorum, et fiat per duas manus electionum in ipso consilio, et una per scripturam inter dominum, consiliarios, capita, et sapientes utriusque manus cum salario librarum XXIII or grossorum in anno et ratione anni; quod salarium recipere debeat pro primo anno ante suum recessum, et postea de sex in sex menses; tenendo duos famulos ad suum salarium et expensas, qui sint a viginti annis supra et quinquaginta infra, nec sint Albanenses vel de Durachio...*". Acta et diplomata II, dok. 481; AAV, p. I, t. II, nr. 445.

¹⁵ Ljubić, Listine, IV, 297-301; Acta et diplomata II, dok. 488; AAV, p. I, t. II, nr. 458

Në vazhden e këtyre përpjekjeve, Republika e Venedikut në tetor të vitit 1392 mori vendim për të dërguar dy proveditorë në Durrës me qëllim që të merrnin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar sundimin e Venedikut në atë qytet,¹⁶ kjo detyrë u ishte besuar Mikel Kontarenos (Michael Contareno) dhe Pjetër Kuirinos (Petro Quirino).¹⁷ Ndërsa, më 14 nëntor 1392, në Venedik merret vendim që këta dy proveditorë të shkojnë në viset e Durrësit, dhe të takohen me kështjellarin venedikas në atë qytet Pal de Kanali (Paulo de Canali) dhe rektorin Marin Kauko (Marino Caucho), me qëllim që të marrin sa më shumë informata rreth fortifikimit të kështjellave të qytetit dhe të territorit të atij vendi ashtu edhe mbi statutet, mbi zakonet, zyrat, taksat, doganat, të ardhurat dhe shpenzimet që në një mënyrë ose në një tjetër ndodhën ose zhvillohen në atë qytet.¹⁸

Proveditorëve venedikas që do të dërgoheshin në Durrës, Mikel Kontarenos dhe Pjetër Kuirinos, Republika e Venedikut u kishte dhënë kompetenca të shpenzonin nga të hollat e komunës së Durrësit për të bërë riparimin dhe fortifikimin e kështjellave dhe të mbarë qytetit, gjithnjë duke kërkuar nga ata që këto punë të bëheshin me sa më pak shpenzime që të ishte e mundur,¹⁹ Krahas këtyre masave, Republika e Venedikut u tregua e kujdesshme edhe lidhur me çështjen e të ardhurave të doganave dhe të taksave, duke i porositur proveditorët në fjalë: “*që të mos bëhet ndonjë ndryshim (reformë) prej anës suaj, por të procedohet sipas zakoneve të vjetra dhe të mira të atij vendi, duke i urdhëruar që pasi të bëjnë një kontroll dhe një hetim të zellshëm, ta rregullojnë punën e të ardhurave, të doganave dhe të taksave në mënyrë të tillë (sa) që të mos mund të bëhet asnjë mashtrim në dëm të komunës sonë ose të personave të veçantë*”.²⁰ Për këtë arsye ata mund të emëronin nëpunës dhe sekretarë (shkrues), me një pagë, sa ata ta shihnin të arsyeshme.²¹

¹⁶ 5 “*Electi duo provisores, ut eant Durachium, et examinent statum illius terrae, et postea informent de rebus et provisionibus, quae sunt et erunt necessariae pro conservando dictum locum ad honorem domini*”. Ljubić, *Listine*, IV, 296; *Acta et diplomata II*, dok. 486; AAV, p. I, t. II, nr. 456; Malltezi, “Përpjekjet dhe synimet”, 169.

¹⁷ “*Ellecti provisores Durachii: ser Michael Contareno, ser Petrus Quirino*”. *Acta et diplomata II*, dok. 486; AAV, p. I, t. II, nr. dok.456.

¹⁸ Ljubić, *Listine*, IV, 297-301; *Acta et diplomata II*, dok. 488; AAV, p. I, t. II, nr. 458.

¹⁹ “... *Quibus de causis habeatis libertatem expendendo de pecunia nostri communis deinde, faciendo pro hoc principio quam minores expensas poteritis...*”. Ljubić, *Listine*, IV, 297-301; AAV, p. I, t. II, dok.458.

²⁰ Ljubić, *Listine*, IV, 297-301; *Acta et diplomata II*, dok. 488; AAV, p. I, t. II, nr. 458.

²¹ Ljubić, *Listine*, IV, 297-301; *Acta et diplomata II*, dok. 488; AAV, p. I, t. II, nr. 458.

Emërimi i qeveritarëve dhe nëpunësve tjerë të aparatit qeveritar venedikas në Durrës vazhdoi edhe në fillim të vitit 1393. Më 3 janar të po atij viti, në Venedik u mor vendim që të zgjidhej rektori i Durrësit, me titullin bajl kapiten, i cili do të shërbente për një periudhë kohore dy-vjeçare dhe do kishte nën juridiksion qytetin e Durrësit dhe kështjellat në varësi të tij.²² Në këtë vendim bajl kapiteni i Durrësit udhëzohej që të ushtrojë drejtësinë sipas statuteve dhe rregulloreve të qytetit të Durrësit, të cilat në rast se do të mungonin të zëvendësoheshin me statutet e Venedikut. Për shërbimet që bajl kapiteni do t'i kryente, i ishte caktuar një pagë prej nëntëdhjetë libra në vit (*libras nonaginta grossorum in anno*). Gjithashtu në këtë vendim cekej që bajl kapiteni i zgjedhur, të mbajë me shpenzimet e veta një bashkëpunëtor venedikas, dhe një noter (*teneat suis expensis unum socium venetum, unum notarium etc*).²³ Dokumentet e lëshuar më 20 shkurt 1393 në Venedik, dëshmojnë se në pozitën e bajl kapitenit të Durrësit ishte emëruar Françesk Gjorgjio (Francisci Giorgio), ku me këtë rast i shkruhej kështjellarit të Durrësit, Paul de Kanalit, se tani e tutje për të gjitha gjërat duhet t'i bindej zotit Françesk –Gjorgjios.²⁴ Përveç bajl kapitenit, Republika e Venedikut më 3 janar 1393 zgjodhi edhe financierin e Durrësit (camerarius Durachii)²⁵ në kompetencën e të cilit ishte administrimi i zyrës së financave apo dhomës,²⁶ siç quhej në mesjetë kjo zyrë. Në mesin e detyrave që ai duhej t'i kryente me rastin e shërbimit të tij në Durrës në pozitën e dhomëtarit, ishte edhe: “... *nxjerrja e të gjitha të ardhurave të qytetit si dhe të kështjellave dhe vendeve që i përkisnin qytetit të përmendur*”.²⁷ Për shërbimet që do t'i kryente në

²² “...*rector dicte ciuitatis et omnium castrorum et locorum spectantium et pertinentium dicte ciuita ...*”. AAV, p. I, t. II, nr. 464

²³ “...*Statuitur, ut eligatur baiulus et capitaneus Durachii per duos annos illic gubernaturus iustitiamque facturus secundum statuta et ordines civitatis Durachii, quae si deficerent, secundum statuta Venetiarum. Habeat pro salario libras 90 gross. In anno de introitibus; teneat suis expensis socium unum Venetum, unum notarium...*”. Ljubić, *Listine*, IV, 302; *Acta et diplomata* II, dok. 491; AAV, p. I, t. II, nr.464.

²⁴ “...*Scribitur domino Paulo de Canali castellauo Durachii, quod de caetero debeat esse in omnibus ad omnem obedientiam domini Francisci Giorgio...*”. Ljubić, *Listine*, IV, 303; *Acta et diplomata* II, dok. 494; AAV, p. I, t. II, nr.479.

²⁵ “...*Eligatur unus camerarius Durachii, qui debeat exigere omnes introitus, redditus et proventus nee non omnes regalias et honorificentias tam dictae terrae quam castrorum et locorum solitorum respondere terrae predictae etc. cum salario librarum quindecim grossorum in anno etc...*”. Ljubić, *Listine*, IV, 302; *Acta et diplomata* II, dok. 492; AAV, p. I, t. II, nr. 465

²⁶ *Dokumente për historinë I*, 651.

²⁷ “*Eligatur unus camerarius Durachii omnes introitus, regalias, honorificentias dictae*

Durrës, ai do të kompensohej me një pagë prej pesëmbëdhjetë libra në vit (*cum salario librarum quindecim grossorum in anno*).²⁸ Ndërsa, më 27 janar të po atij viti, Republika e Venedikut mori vendim që të zgjidhet një admiral për qytetin e Durrësit me arsyetimin se është e nevojshme të ketë një admiral atje.²⁹ Në vendet porte siç ishte edhe qyteti i Durrësit, admirali kishte detyrën e shefit të portuale.³⁰ Edhe për admiralin në fjalë Republika kishte vendosur që të paguhej me një pagë prej 50 dukat ari në vit.³¹

Ndryshe nga vendimet e përmendura më lart, më 20 shkurt 1393 në Senatin e Venedikut ishte vendosur që bajl kapitenit të Durrësit t'i jepeshin armë të caktuara (*certa arma*), siç thuhej aty, për mbrojtjen e qytetit tonë të Durrësit (*pro custodia ciuitatis nostre durachij*).³² Rreth dy muaj pas këtij vendimi, Senati i Venedikut kishte vendosur që t'i bëhet pagesa Marin Kaukos i cili në nëntor të vitit 1392 përmendet si rektor i Durrësit. Me sa duket, Marini në këtë post kishte shërbyer vetëm dy muaj, së bashku me katër shërbyes me shpenzimet e veta. Për këtë qëllim, më 10 prill 1393, Senati kishte caktuar shumën prej 40 dukatë flori, që t'i jepen Marinit për shërbimin e kryer dhe për shpenzimet e bëra gjatë asaj kohe. Sipas këtij vendimi, rektori në fjalë gjatë kohës sa kishte qeverisur në Durrës kishte mbajtur një qëndrim për t'u lavdëruar (*in quo Regimine laudabiliter se gessit*).³³

terrae exacturus". Ljubić, *Listine*, IV, 302

²⁸ Ljubić, *Listine*, IV, 302; *Acta et diplomata* II, dok. 492; AAV, p. I, t. II, nr.465.

²⁹ "...*sit necessarium habere ibi unum Armiraleum...*". AAV, p. I, t. II, nr.472; Luan Malltezi, "Përpkjekjet dhe synimet e Venedikut për pushtimin e Durrësit(1386-1392)", *Studime për Epokën e Skënderbeut* II, Tiranë 1989, 151.

³⁰ *Dokumente për historinë I*, 649.

³¹ "...*pro Durachio eligatur unus amiraleus cum salario ducatorum 50 auri in anno...*".

Ljubić, *Listine*, IV, 303; *Acta et diplomata* II, dok. 493; AAV, p. I, t. II, nr.472.

³² "*Quod pro custodia ciuitatis nostre durachij mandetur patronis nostri arsenatus, quod debeant pro dicta causa, nobili viro, ser Francisco georgio Rectori nostro dicte terre consignare, Cassas decem veroto ballistas quinquaginta fulcitas cum crochis, pauese rigina, lancea s centum, a posta, bombardas quatuor fulcitas lapidibus et aliis opportunis, ac decem barilia puluer, a bombardis*". AAV, p. I, t. II, nr. 481.

³³ "*Quia sicut notum est nobilis vir ser M arinus caucho de mandato nobilis viri ser Saraceni dandulo, tune capitanei nostri Culphy, stetit pro Rectore Ciuitatis nostre durachij men ibus duobus cum quatuor famulis, ad suas expensas, in quo Regimine laudabiliter se gessit, prout nobis scripserunt prouisore nostri, Vadit pars, quod dentur ei de pecunia nostri comunis, pro expensis per eum factis in dicto loco ducatos quadraginta auri*". AAV, p. I, t. II, nr.484.

Ballafaqimi më kërkesat e popullsisë vendase

Konsolidimi i sundimit venedikas në Durrës u shoqërua edhe me zbatimin e pjesshëm ose moszbatimin dhe mosrespektimin e statuteve dhe rregullave të vjetra të qytetit, edhe pse me rastin e dorëzimit të Kështjellës së Durrësit nga ana e Gjergj Topisë, thuhej se: si vetë Gjergji edhe venedikasit detyrohen të respektojnë statutet dhe rregullat e qytetit të Durrësit.³⁴ Pa kaluar pothuajse një vit nga vendosja e sundimit venedikas në Durrës, Republika e Venedikut u përballë me kërkesa të shumta që durrsakët i drejtoheshin lidhur me rregullimin e shumë çështjeve të brendshme, të cilat ndërlihdeshin me organizimin dhe funksionalizimin e këtij qyteti. Nga përgjigjet që Venediku ua kthente kërkesave të durrsakëve, vërehet se kërkesat e tyre (durrsakëve) nuk i refuzonte, por në përgjithësi mendohej që t'i modifikonte duke u bërë ndryshime të pjesshme gjithnjë në favor të politikave dhe interesave të veta. Kështu kishte vepruar më 17 gusht 1393, kur iu përgjigj disa kërkesave të dërguara nga përfaqësuesit e qytetit të Durrësit të cilat kishin të bënin me tregtinë, rojën e qytetit, me kullotat, vreshtat, arat, kriporët, mullinj të me ujë, si dhe me disa çështje kishtare. Me këtë rast Republika e Venedikut kishte dërguar këto përgjigje: sa i takon tregtisë për të cilën durrsakët kishin kërkuar që asnjë i huaj përveç venedikasve të mos mund të shes apo të blejë përveçse nga qytetarët durrsak. Ishte marrë vendim që kjo kërkesë të modifikohet në atë mënyrë që asnjë i huaj përveç venedikasve dhe të gjithë nënshetasve të zotërimit të tyre të mos shes as të mos blej përveçse nga qytetarët e Durrësit.³⁵ Sa i përket rojës së qytetit durrsakët kishin kërkuar që asnjë qytetar i këtij qyteti të mos jetë i detyruar për rojën e qytetit derisa të ndodhet jashtë tij, as të mos e bëjë rojën sipas zakonit të vjetër të tyre, mirëpo Republika e Venedikut kishte vendosur që vetëm ata durrsakë të cilët do të nisen për ndonjë udhëtim të mos jenë të detyruar të bëjnë rojën as të paguajnë ndonjë gjë për rojet përveçse në rast lufte.³⁶

³⁴ “...*Tam ipse Georgius quam Veneti statuta et ordinationes civitatis Durachii servare tenentur...*”. *Acta et diplomata* II, dok. 480.

³⁵ Ljubić, *Listine*, IV, 311; *Acta et diplomata* II, dok. 506.

³⁶ “...*quod nullus civis dicte civitatis teneatur ad custodiam ipsius civitatis, donec fuerit extra eam, nee solvat guardiam secundum eorum antiquam consuetudinem; vadit pars, quod dictum capitulum dictis Duracenis confirmetur in hunc modum, videlicet, quod illi ex predictis, qui ibunt ad aliquod viagium, non teneantur facere guardiam nee solvere pro custodiis aliquid, excepto quam in casu novitatis...*”. Ljubić, *Listine*, IV, 311; *Acta et diplomata* II, dok. 506.

Siç e cekëm edhe më lart, durrsakët kishin dërguar kërkesa edhe lidhur me disa çështje kishtare ku kishin kërkuar që fretërit, klerikët, manastiret, kishat si dhe pasuritë e tyre të jenë sipas tagreve dhe zakoneve të lira e të paprekur dhe krejt zot të lëmoshës së vetë. Edhe për këtë kërkesë ishte marrë vendim që të modifikohet në këtë mënyrë d.m.th. të gjitha lëmoshat t'u jepen fretërve, klerikëve, manastireve dhe kishave, të jenë të lira dhe të përjashtuara nga të gjitha taksat dhe doganat, duke mos përfshirë në këtë koncesion të ardhurat dhe të korrat e manastireve, të kishave dhe të fretërve të përmendur dhe të klerikëve.³⁷

Ruajtja e raporteve me fqinjët, privilegjet dhe dhuratat

Vend me rendësi në konsolidimin e sundimit venedikas në Durrës zinte edhe ruajtja dhe krijimi i raporteve të mira me të gjithë ata fisnikë zotërimet e të cilëve shtriheshin përreth Durrësit. Në këtë drejtim, Republika e Venedikut bëri përpjekje që me anë të disa privilegjeve t'i mbanin afër vetës, me një fjalë të mos i kishin kundërshtarë. Kështu vepruan me Niketë Topinë, të cilin e konsideronin njërin ndër fisnikët më me influencë në rrethin e Durrësit.³⁸ Me qëllim të ruajtjes së raporteve të mira me të, Republika e Venedikut më 15 prill 1393, kishte vendosur që Niketë Topisë t'i jepet leja për ndërtimin e një kështjelle pranë Durrësit, në vendin e quajtur Kepi i Melieve (caput de le Melic), me arsyetimin se vetë konti personalisht në Durrës ua ka kërkuar me ngulm ndërtimin e një kështjelle.³⁹ Republika e Venedikut edhe më tej në vendimet dhe udhëzimet që u dërgonte qeveritarëve të saj në Durrës e konsideronte Niketë Topinë si besnik të zotërimeve të tyre në ato vise. Për të vazhduar dhe ruajtur këto raporte, më 28 shtator 1394 në Venedik u vendos që t'i dërgohen bajl kapitenit të qyteti të Durrësit dy copë stofë Fiorentine (Florentinorum), një të verdhë e një të kuqe, të cilat kishin vlerë 120

³⁷ "...*Super tercio capitulo, per quod petunt, quod ecclesie latine et greca tam de archiepiscopatii quam de episcopatu nec non clerici et monasteria et eorum res sint secundum eorum iura et consuetudines Uberi et immunes et potissime sue elemosine; vadit pars, quod dicta peticio reformetur in hunc modum, videlicet, quod omnes elemosine, que date fuerint fratribus, clericis, monasteriis et ecclesiis, sint libere et franche ab omnibus datiis et gabellis, non intelligendo in hac concessione redditus et proventus monasteriorum, ecclesiarum et dictorum fratrum et clericorum...*". Ljubić, *Listine*, IV, 311; *Acta et diplomata* II, dok. 506.

³⁸ "...*in districtu nostro Durachii sit quidam nobilis valde potens qui vocatur comes Nicheta...*". *Acta et diplomata* II, dok. 496.

³⁹ Ljubić, *Listine*, IV, 304; *Acta et diplomata* II, dok. 496; Božić, "Albania i Albanci", 56.

dukatë, duke i porositur që në rast se e sheh të arsyeshme t'ua ndajë ata stofa Niketë Topisë dhe vjehrrit të tij Kominit (Cominum),⁴⁰ me pretekstin se ia vlente të mbaheshin në dashuri dhe në dashamirësi të komunës ata dy fisnikët shqiptarë “që janë besnikë të zotërimit tonë në viset e Durrësit” (*illos duos nobiles Albanenses, qui sunt fideles nostro dominio in partibus*).⁴¹

Përveç ruajtjes së fqinjësisë së mirë, Republika e Venedikut u kujdes që të shpërblejë me dhurata të gjithë ata që e përkrahën me rastin e marrjes së Durrësit. Privilegje dhe dhurata të kësaj natyre Republika e Venedikut kishte bërë që në vitet e para të vendosjes së sundimit të saj në Durrës, për të gjithë ata persona të cilët që nga koha kur Gjergj Topia ishte gjallë i kishin mbrojtur interesat venedikase. Në këtë drejtim, fillimisht Republika e Venedikut kishte vendosur që t'u rriste pensionet.⁴² Për këtë qëllim më 15 prill të vitit 1393, në Venedik ishte marrë vendim që t'u jepet provizion në vlerë 40 dukatë në vit, tre personave: zotit Burila (dominus Burila), Andre Muzaka (Andreas Musachi) dhe Progon Skurës (Perganus Scuro), të cilët para se Durrësi të kalonte nën sundimin e Venedikut kishin marrë nga 30 dukatë në vit.⁴³

Me këtë rast kishte përfituar edhe Andrea Nesa, vëllai i peshkopit Dhimitër Nesa. Republika e Venedikut duke marrë parasysh kontributin e Dhimitër Nesës lidhur me kalimin e Durrësit nën zotërimin e tyre, ndër të tjera në këtë vendim deklaronte se Dhimitër Nesa “vazhdimisht ka qenë shkak kryesor për të shpejtuar dhe për të ngulur këmbë Republika të merrte zotërimin e atij qyteti, dhe Andrea Nesa vëllai i atij peshkopi është njëlloj shumë besnik ndaj zotërimit tonë”.⁴⁴ Prandaj kërkohet që Andrea Nesa, të kishte të njëjtat kushte e trajtim si të provizionuarit e tjerë,⁴⁵ pra edhe ai të merrte provizionin prej 40 dukatë në vit.⁴⁶ Për besnikërinë e treguar ndaj Republikës, kjo e fundit më 15 prill 1393, kishte vendosur që

⁴⁰ Ljubić, *Listine*, IV, 337; *Acta et diplomata* II, dok. 526; AAV, p. I, t. II, nr.570.

⁴¹ Po aty.

⁴² Božić, “Albania i Albanci”, 56.

⁴³ “... *et predicti provisionati de quibus nisi tres restant videlicet dominus Burila, Andréas Musachi et Progonns Scuro... qui provisionati ita modo habeant de provisione pro quolibet ducatos triginta, sicut prius habebant, antequam dominium dicte civitatis esset nostrum...*”. *Acta et diplomata* II, dok. 496; AAV, p. I, t. II, nr.488

⁴⁴ “...*qui episcopus continuo fuit principalis causa solicitandi et instandi, ut dominatio nostra haberet dominium civitatis eiusdem et idem Andreas Nesa frater ipsius episcopi similiter sit fidelissimus nostri domini...*”. *Acta et diplomata* II, dok. 496; AAV, p. I, t. II, nr.488.

⁴⁵ *Acta et diplomata* II, dok. 496; AAV, p. I, t. II, nr.488

⁴⁶ Ljubić, *Listine*, IV, 304; *Acta et diplomata* II, dok. 496; AAV, p. I, t. II, nr.488.

ta shpërblej me 40 dukatë në vit edhe Inklet Shqiptarin (Inclethi Albanensis), i cili që në kohën e Gjergj Topisë kishte qenë kështjellar i kështjellës së sipërme të Durrësit (castellanus Castris superioris durachij).⁴⁷ Gjithashtu Republika e Venedikut nuk la pa shpërblyer edhe persona të tjerë të cilët u kishin ndihmuar me rastin e marrjes së Durrësit. Për këtë qëllim më 18 prill 1393, Republika e Venedikut kishte vendosur që të dërgonte në Durrës pëlhura për t'u ndarë mes baronëve dhe fisnikëve shqiptarë (*baronibus et nobilibus de l'Albano*) vlera e të cilave arrinte në 355 dukatë.⁴⁸ Me këtë rast dhurata kishin marrë këta persona: Komin Spata (Comini Spata), kont Niketa (Comiti Nicheta), Andrea Venapulo (Andree Venapula), Martin Skura (Marthin Scura), Budino (Budino), Progano Sakato (Progano Sachato), Kruakus (Cruachus), konti Guoro (Comiti Guoro), Simeon Jata (Simeon Jatta).⁴⁹ Vlera e dhuratave, saktësisht sasia e pëlhurave që ishte ndarë në mes të këtyre personave dallonte. Me sa duket ata ishin shpërblyer në bazë të kontributit që kishin dhënë me rastin e marrjes së Durrësit nga ana e Venedikut. Duke u nisur nga ky parim, Republika e Venedikut kishte vendosur që së pari zotit Komin Spata (primo dentur domino Comini Spata) t'i jepen katër copë pëlhurë, konti Niketa tri copë pëlhurë dhe Budino dy copë, ndërsa me nga një copë pëlhurë ishin shpërblyer: Andrea Venapulo, Martin Skura, Progano Sakato, Kruakus, konti Guoro dhe Simeon Jata. Vlera e pëlhurave ishte njëzet, tetëmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë dukatë.⁵⁰ Përveç kësaj,

⁴⁷ "...Cum in civitate Durachii sit quidam Inclechi Albanensis qui continuo fuit castellanus Castris superioris durachii, tempore quondam domini Georgij et qui tanquam fidelissimus nostri domini die noctuque vigilavit ad honorem nostri domini, et in dicto Castro elevavit vexillum sancti marci, ita fideliter se gerendo, quod merito debeat prouideri. Vadit pars pro omni bono respectu et pro evidenti exemplo aliorum quod dictus Indethi tamquam verus servitor nostri domini recipiatur, et sit ad conditionem aliorum provisionatorum videlicet qui annuatim habere debeat a dominio nostro pro prouisione sua ducatos quadraginta...". Ljubić, *Listine*, IV, 304; *Acta et diplomata* II, dok. 496; AAV, p. I, t. II, nr.489

⁴⁸ "...Item ordinetur et sic vadit pars, quod pro bona beneintrata domini nostri in summendo dominium civitatis Durachii debeat dispensari et donari baronibus et nobilibus de l'Albano pannus ad valorem ducatorum 355; qui pannus debeat dividi inter ipsos barones et nobiles prout extitit in Durachio consultum per baiulum et capitaneum et provisos nostros et ut patet per unam cedula per ipsos examinatam et translata...". Ljubić, *Listine*, IV, 304; *Acta et diplomata* II, dok. 497; AAV, p. I, t. II, nr. 494.

⁴⁹ *Acta et diplomata* II, dok. 497; AAV, p. I, t. II, nr. 494; Malltezi, "Përpyjekjet dhe synimet", 161; Schmitt, *Arbëria Venedike*, 233.

⁵⁰ "...Primo dentur domino Comini Spata pecie IIII panni: 2 a ducatis 20 et 2 a ducatis 16; Comiti Nicheta pecie III: 2 a ducatis 16 et 1 a ducatis 20; Andree Ervopula pecie a

Republika e Venedikut më 18 prill 1393, kishte marrë vendim që bajl kapitenit të Durrësit t'i dërgohen edhe katër topa pëlhurë, secili në vlerë prej 16 dukatë, të cilat ai duhet t'i ndante midis baronëve dhe fisnikëve të tjerë siç do t'i duket atij me vend "për nderin e zotërimit tonë" (pro honore nostri domini),⁵¹ thuhet në këtë vendim.

Siç shihet, materialet në të cilat jemi mbështetur gjatë trajtimit të këtij punimi argumentojnë se konsolidimi i sundimit venedikas në Durrës u karakterizua me këtë zhvillim kronologjik të ngjarjeve: fillimisht kemi emërimin e kështjellarit për Kështjellën e Durrësit, emërimin e zyrtarëve dhe qeveritarëve tjerë venedikas në Durrës, si dhe kompletimin e administratës, gjatë të cilit proces Republika e Venedikut u përkujdes të emërojë persona të besueshëm, siç kemi rastin me vendimin e lëshuar nga Senati i Venedikut në prill të vitit 1392. Së dyti, ballafaqimin me popullsinë vendase përkatësisht me kërkesat e tyre drejtuar sinjorisë për respektimin e marrëveshjes me Karl Topinë si dhe implementimi i asaj marrëveshjeje, e cila në shumicën e rasteve ishte e njëanshme, po ashtu edhe me pretendimet dhe përpjekjet e Republikës së Venedikut ku përveç Durrësit synonte që të merrte edhe zotërimet tjera të Topiajve; si dhe me trajtimin e një varg çështjesh tjera si: ruajtja e raporteve me fqinjët, dhuratat dhe privilegjet për të gjithë ata që e përkrahën, si dhe një sërë çështjesh tjera të cilat u referohen politikave që Republika e Venedikut i ka ndjekur që nga viti 1392 e deri në vitin 1396, kur edhe fillon lufta për shkëputjen e këtij qyteti dhe qyteteve të tjera (Lezhës, Shkodrës dhe Drishtit) nga sundimi venedikas.

ducatis 16; Marchia Scura peza 1 ½ a ducatis 18 pecia; Budio pecie II a ducatis 20 pecia; Prozano Sachato pecia 1 a de ducatis 20; Cruachul pecia 1 a a ducatis 20; comiti Guoro pecia 1 a a ducatis 20; Scura pecia 1 a a ducatis 20...". *Acta et diplomata* II, dok. 497; AAV, p. I, t. II, nr. 494.

⁵¹ "...Item mittantur pecie IIII a ducatis 16 singula baiulo et capitaneo, quas dividere debeat inter alios barones et nobiles prout sibi videbitur pro honore nostri domini". *Acta et diplomata* II, dok. 497; AAV, p. I, t. II, nr. 494.

Teuta SHALA-PELI

SUMMARY

CONSOLIDATION OF VENICE RULE IN DURRES 1392-1394

City of Durres was governed by the noble family of Topiaj at the end of the sixteenth century. In the context of this study, we have examined thoroughly a very specific issue concerning the establishment of Venetian rule in Albania, respectively the consolidation of this rule in Durres, based on the source material and pertinent literature.

Taking into account the policy applied by the Republic of Venice, after the capture of this city, we have analyzed those events and historical processes that characterized the time period 1392-1394, which simultaneously marks the phase of concentration and strengthening of the Venetian rule in Durres.

Initially, emphasis of the paper is on the events of 1392-1393, which included the designating the administrator of the “Durres Fortress” and the appointments of “rectors” and other Venetian authorities in Durres. A particular analysis has been dedicated to the establishment and completion of the administration, as well as the confrontation of the local population, namely their requests to the lordship regarding respecting and implementation of the agreement with Karl Topia, which in most cases was unilateral, as well as dealing with a number of other issues that refer to the policies that the Republic of Venice followed from 1392 to 1396, after which the war for the secession of this city of Durres and other cities (Lezhe, Shkodra and Drishti) from Venetian rule, commenced.